

STATUTI
I SHOQERISE' ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"LUXCOM" SH.P.K..

Sot ,me 01/04/2021 , ne baze te Kushtetutes dhe te Kodit Civil ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ne baze te ligjit ne fuqi Nr7512 ,date 08.10.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private Siper marrjeve te lira dhe aktiviteve private dhe privatizimit" te ligjit N.9901 ,date 14.04.2008, "Per marredheniet tregtare" dhe ne baze te ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per qendren kombetare te regjistrimeve" ,qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare,me vullnetin e saj te lire ,te nenshkruar ne kete Statut,i cili vlen dhe si Akt Themelimi:

Ciro Ruta lindur ne Napoli me 04/03/1975 ne Itali, me numer dokumenti AU7103090, I cili ka vendosur te hartohet Statuti i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar, aktiviteti i se ciles do te rregullohet mbi bazen e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi, sipas Akt Themelimit dhe Statutit te Shoqerise bashkangjitur.

Neni 1 – Emertimi

1.1 Emertimi i Shoqerise eshte **LUXCOM Sh.p.k.** (e cilesuar me poshte si "Shoqeria").

Neni 2 – Forma ligjore

2.1 Shoqeria **LUXCOM Sh.p.k.** eshte e themeluar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe eshte e rregulluar sipas Statutit te saj si me poshte vijon,dhe ka vlere ne baze te legjislacionit shqiptar dhe si Akt Themelimi

2.2 Shoqeria operon ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Neni 3 – Selia

3.1 Shoqeria operon me seli ne adresen: Tirane,Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit",Pallati 68,Hyrja 10,Apartamenti 15.

3.2 Shoqeria mund te kete zyra, dege, perfaqesi dhe agjensi si brenda Shqiperise ashtu edhe jashte shtetit shqiptar.

3.3 Mbledhja e Ortakeve,mund te vendose, transferoje dhe/ose te mbylle, si brenda edhe jashte shtetit shqiptar, dege sekondare, filiale,seli, agjensi, zyra perfaqesimi dhe bashkesi lokale te cdo natyre.

Neni 4 – Objekti

4.1 Shoqeria ka ne objektin e saj social cdo operacion legjitim tregtar qe perfshin pa kufizim aktivitetet e listuara si me poshte:

I. Shoqeria ka ne objektin e saj social ofrimin e shërbimeve për bizneset dhe entitetet publike dhe private në sektorët e menaxhimit, administrativ, organizativ, tregtar, financiar dhe te ngjashem. Pra, si shembull dhe pa perjashtim shoqeria mund te kryeje sherbimet si ne vijim:

- Trajnime te personelit

- Kerkim seleksionim stafi

- Konsulence per menaxhimin e biznesit me fokus primar ne menaxhimin strategjik te burimeve njerezore , analizen e bilancit, kontrollin e menaxhimit të procedurave organizative, kontrollet e kontabilitetit

- Konsulence marketing dhe tregtare

- këshilla për blerjen, menaxhimin dhe shitjen e investimeve të kapitalit të të gjitha llojeve dhe tipologjive të kompanive, entitete dhe te ngjashem por pa kryer aktivitetet e specifikuar te profesionisteve te regjistruar në regjistrat profesionalë të veçantë.

II. Pervetesimi, transkriptimi përpunimi i të dhënave dhe statistikave përkatëse duke përdorur pajisje mekanike, elektronike dhe te ngjashme, prone te sajat dhe te paleve te treta per menaxhimin e kontabilitetit fiskal dhe te se drejtes civile, dokumenta pune dhe te tjera te perpunuar per llogari te shoqerive, ekspozues artesh dhe profesionesh, entitete publike dhe private.

III. Përpunimi i të dhënave per llogari te saj dhe palëve të treta; ekzekutimi i shërbimeve teknike, tregtare, përpunimi i kontabilitetit, hulumtimi i tregut dhe auditimi; shërbimet e organizimit të biznesit, kontrolli i menaxhimit, organizimi administrativ, kërkimi dhe seleksionimi i stafit, organizimi i kurseve, seminareve, konferenca për çështje biznesi.

IV. Aktivitetet e pasurive të patundshme dhe të ndërtimit në formën më të gjerë dhe, veçanërisht, me shembull: blerja, ndërtimi, prishja, rinovimi, rindërtimi dhe shitja, bllok ose te ndara, të pasurive të patundshme urbane; blerja dhe shitja e pronave rurale; administrimi dhe dhënia me qira ose marrja me qira, të pronave të çdo lloji. Vendosja e kontratave dhe nënkontraktimi nga personat ose subjektet, publike dhe private, në veprimtaritë e treguara si me siper.

Te marre pjes ne kontraktme apo nenkontraktme nga persona apo ente, si publik ashtu dhe privat, persa i perket aktiviteve te mesiperme. Shoqeria per arrijen e objektivit te saj social do jete ne gjendje te kryeje, ne perputhje totale me normat legjislative ne fuqi, te kryeje cdo aktivitet i lidhur drejtperdrejte me ato te lidhura si ne objektin e saj social ne kete nen dhe ne vecanti te kryeje cdo operacion apo transakcion te pasurive te luajtshme apo te paluajtshme ,tregtar, industrial dhe financiar si dhe konsorciumi, pjesemarrja, te marr kuota pjesemarrje, aksione interesi dhe kuota ne shoqeri te tjera, shoqeri shqiptare dhe te huaja, pjesemarrja ose pajtimi me institucione te tjera publike ose private, kishtare ose civile, shqiptare apo te huaja, me te cilat kane objektiv te njejte apo te ngjashem;

- V. Menaxhimi i pasurive të patundshme në pronësi dhe për palët e treta;
- VI. Qiraja (me përjashtim të qirasë aktive) të pronave në pronësi;
- VII. Tregtia me shumicë dhe pakicë, si dhe import-eksporti i automjeteve, makinave, makinave për industri;
- VIII. Do jete ne gjendje te marre kredi dhe cdo forme financimi me shoqerite e financimit, bankat, shoqerite private duke lene garancite e duhura mobiliare dhe immobiliare, reale dhe personale.

Neni 5 – Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqerise është vendosur deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

Neni 6 – Kapitali

- 6.1. Kapitali eshte 10.000 (dhjete mije) leke i perbere nga 1 (nje) kuote e barazvlefshme me vlere nominale perkatesisht 10 000 (dhjetemije) leke te **Ciro Ruta -s**
 - 6.2 Kapitali i shoqerise eshte plotesisht i regjistruar dhe i leshuar ne menyren e meposhtme:
- Ciro Ruta** zoteron 100% (njqind perqind) te kapitalit te shoqerise i barazvlefshem me 1(nje) kuote.

Neni 7 – Mundësia e transferimit të kuotave

7.1 Kuotat sociale jane te transferueshme tek palët e treta në përputhje me dispozitat e akteve nënligjore te parashikuara ne STATUT.

Neni 8 – Administratorët

- 8.1 Shoqëria mund të administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të lirë të veprojnë veçmas ose bashkarisht sipas asaj që do të vendoset në rastin e emërimit.
- 8.2 Administratorët nuk duhet të jenë medoemos edhe aksionerë dhe veprojnë në rolin e tyre derisa të japin dorëheqje ose shkarkohen nga Asambleja e Aksionerëve, ose për një periudhë tre-vjeçare (3) me mundësinë për t'u riemëruar.
- 8.3 Përfundimi i mandatit të Administratorëve hyn në fuqi në momentin kur emërohet organi i ri administrues.
- 8.4 Administratorëve u takon të përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe në gjykim dhe kompetencat më të gjëra administrative, që mund të ushtrohen në harmoni me atë që përcakton artikulli 95 i ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" dhe ndryshime pasuese, por në çdo rast, brenda kufijve të përcaktuar në rastin e emërimit dhe nga ky Statut.
- 8.5 Administratorët mund të emërojnë prokure te veçantë për një akt ose një sërë aktesh.

8.6 Funkzioni administrativ kryhet sipas nje tarife te parashikuar ne ligj. Administratorëve u takon rimbursimin e shpenzimeve që kanë në lidhje me funksionin e tyre administrativ.

8.7 Me kete akt themelimi vendoset si Administratore i Shoqerise:

LEDJONA SYLYKU lindur ne BERAT,SHQIPERI me 20/03/1997 e bija e Nevil -it dhe numer dokumenti J75320061B.

Artikull 9 – Gjuha

9.1 Ky Statut hartohet në gjashtë (6) kopje, tri (3) në gjuhën shqipe dhe tri (3) në gjuhën italiane.

9.2 Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij Statuti, versioni i tij në gjuhën italiane do të jetë i vetmi me vlerë të detyrueshme ligjor.

9.3 Ky akt miratohet në çdo artikull nga themeluesit e vetëm te Shoqërisë **LUXCOM Sh.p.k** i cili nenshkruan me emrin, mbiemrin dhe firmën e vet të gjitha kopjet.

* * *

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Ciro Ruta

CIRO RUTA
